



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Mbledhja e radhes e Këshillit Bashkiak Muaji QERSHOR mbajtur sot me datë 30/06/2026 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Merr pjese ne mbledhje Kryetari i Bashkise, z. Besion Ajazi.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak, "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjesit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet.

E E.Zani: Pershendetje, kurumi eshte plotesuar, niim mbledhjen.

E.Guri: Ngre shqetesimin lidhur me vonesat e materialeve qe nuk vijne ne kohe sipas rregullores dhe dispozitave ligjore, dhe ngre shqetesim edhe per mbledhjejn e komisioneve te cituar ne disa mbledhje.

E.Zani: Hedhim ne votim rendin e dites, me 8 pika?

*Miratohet rendi ditës me 14 Vota PRO.

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermysi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Luljeta Dollani *Ramazan Braho*

Çështja 1

1- Për dhënien e ndihmës ekonomike për muajin Maj 2026 (fondi 6%).

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri.

Pergj.Ndh,Ek: Pershendetje, per muajin Maj 2026 jane gjeneruar nga sistemi elektronik i ndihmes ekonomike 42 familje gjithsej, NJA Tunje ka refuzuar 2 familje per kete muaj sepse kane plotesuar afatet, ndaj rezultojne 2 familje me pak se muaji i kaluar.

E.Zani: Keni pyetje ? Votojme?

***Miratohet pika 1 e rendit te ditës me 14 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Luljeta Dollani, *Ramazan Braho*, *Enis Zani*

Çështja 2

2- Për trajtimin financiar të dëmeve të shkaktuara nga zjarret e muajit Gusht 2025 në territorin e bashkisë Gramsh.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri.

E.Blloshmi: Ketu jane te gjithë preventivat e elektro shtepiakeve, cfare kane patur brenda ne shtepi secila familje qe u prek nga zjarri . Kompesimi do te jete ne 50% te vleres.

E.Guri: Shoh ne komision 15 anetare duhet te ishte edhe Kryetari i fshatit ne komision. Te ishte paraqitur preventivi ne material.

E.Blloshmi: Ne i kemi te gjithë preventivet, mund tjua ve ne dispozicion.

L.Dollani: Mendoj qe materiali eshte i plote, nese do te ishte mbledhur Komisioni do te ishte edhe me mire.

B.Ajazi: Gjate evidentimit te demeve eshte ere edhe evidentimi i demeve ne elektroshtepiake, ku kane firmosur edhe nje prej anetareve te familjeve prezente. Ne menduam qe nje pjese te fondit qe na ka ardhur ta cojme per demshperblim ne 50%te vleres per keto familje. Jemi perpjekur te ndihmojem sa mundemi e ti ndihmojem sebashku.

F.Cekrezi: Materiali eshte i plote, shuma totale e fondit sa eshte?

E.Blloshme: 9 mln 342 128 leke vlera e fondit nga Agjensia e Mbrojtjes Civile.

F.Cekrezi: Lidhur me demshperblimin e gjese se gjalle dhe vreshtarise?

B.Ajazi: Nuk ka nje informacion zyrtar qe te dai VKM ne maj/ qershor , di te them qe nga komunikimi me Agjensine Kombetare Civile , qe brenda vitit perfundon e gjithë faza e demshperblimit te banesave. Lidhur me tjetren, po perpiqemi te gjejme nje mekanizem ligjor bashke me Ministrine e Bujqesise per demshperblimin e gjeses se gjalle , sepse nuk ka nje rast te meparshem er tju referuar. Bashkia i ka mbeshtetur familjet e demtuara me ushqim oer bagetine , edhe duke u dhene gje te gjalle aq sa kemi mundur, bashke me shoqatat, organizatat etj...


E.Zani: Votojme?

***Miratohet pika 2 e rendit te ditës me 14 Vota PRO**


Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

**Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini**



**Kryetari Këshillit
Enis Zani**



Çështja 3

3- Për kalimin në fond banese të objektit "Ish-Dega e Tatimeve" pasuria nr.9/97-N2 dhe 9/97-N3, në pronësi të Bashkisë Gramsh,për qëllime strehimi dhe privatizimi.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani,Luljeta Dollani,Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori,Dalip Hazizaj, Ramazan Braho,Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala,Edmond Guri.

Dr.Urbanistikes: Ky objekt ka patur prej vitesh kerkesa per privatizim, mbeshtetur ne VKM 54 dt 5.2.2014 jane lejuar te behen punime ne objektet e dhena me qera per shkak te mungeses se fondeve buxhetore. Kerkohet qe ky objekt te kalohet ne fond banese , qytetaret kane kontrata prej 12 vitesh me bashkine dhe kane qene te rregullt me faturat.(citon perfituesit sipas relacionit) Qytetaret e kane mbajtur prej vitesh me fondet e veta kete prone , tani ti ndihmojme per fazen e privatizimit.

V.Bici: Lidhur me kete pike, per shkak te konfliktit te interesit(lidhje familjare me personat perfitues), per efekt procedure nuk do te marr pjese ne votim.

F.Cekrezi: Ka te tjera objekte ne proces privatizimi?Pse nuk eshte bere me pare kjo?

B.Ajazi: Do vijne edhe disa godina te tjera per privatizim , muajin tjetër do vijne ish/Shiku dhe Shqopat ndersa X dhe disa godina te tjera po pergatitet materiali qe te kaloje njehere ne pronesi te bashkise dhe me pas ti jepen qytetareve me proces te rregullt blerje.

Vjen ne mbledhje këshilltari A.Bici

***Marrin pjese ne mbledhje 15 keshilltare.**

E.Zani: Votojme?

V.Bici nuk merr pjese ne votim(neni 52 pika 1 a) e Rreg. Keshillit.

***Miratohet pika 3 e rendit te ditës me 14 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

**Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini**



**Kryetari Këshillit
Enis Zani**

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Luljeta Dollani

Ramazan Braho

Valbona Verushi

Çështja 4

4-Për një ndryshim në Vendimin nr. 21 datë 27.03.2026 “Për disa ndryshime në nivelin e pagave e shpërblimeve, të punonjësve e personave të emëruar ose të zgjedhur të Bashkisë Gramsh, për vitin 2026 të Vendimit nr. 86, date 27.12.2024, “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelin e pagave e shpërblimeve, të punonjësve e personave, të emëruar ose të zgjedhur të Bashkisë Gramsh” të Këshillit Bashkiak Gramsh

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri, Alketa Bici.

Dr. Burimeve Njerezore: Drejtora jone ka paraqitur relacionin ku kerkon ndryshim te vendimit 21 date 27/3/2026(citon vendimin), te nivelit te diplomes per profesionin Specialist Muzike(fonist) ne Arsimi larte/Arsim i mesem. Arsyeja e kesaj kerkese vjen si shkak i mungeses se aplikimeve per kete pozicion nga qytetare me arsim te larte. Perfitimet e ketij ndryshimi konsistojne ne nevojat e institucionit dhe ne sherbim te te rinjve te qytetit por edhe ne percjelljen e vlerave kulturore artistike nder breza.Sa me siper propozohet qe ne vendimin nr 21 te shtohet edhe arsimi i mesem per profesionin Specialist Muzike (Fonist).

E.Zani: Keni pyetje? Votojme?

***Miratohet pika 4 e rendit te ditës me 15 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini

Kryetari Këshillit
Enis Zani

Çështja 5

5- Për Miratiminne Shpenzimeve Faktike.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri, Alketa Bici.

Dr.Finances: Sqaron relacionin para keshilltareve .Konkretisht buxheti i miratuar eshte planifikuar per shpenzime: ne paga, per sigurime, shpenzime operative, fond emergjence dhe fond rezerve, transferta korrente te brendshme, shpenzime per investime. Ne nje total prej 884 671 mij eleke. Buxheti 2025 ka per synim :

- realizimin e te ardhurave te bashkise nga taksat/tarifat
- rritjen e shpenzimeve publike ne infrastrukture, sherbime sociale, etj
- rritjen e investimeve ne mbeshtetje te kerkesave te komunitetit
- rritjen e efektivitetit te menaxhimit te shpenzimeve publike
- nxitjen e biznesit dhe siper marrjes.

Te ardhurat nga taksat dhe tarifate vendore per Janar/Dhjetor 2025 kane qene ne shumen 186 989 mij leke ose 59,42% realizim te te ardhurave.. te ardhurat e realizuara paraqiten sipas zerave ne tabelat bashkengjitur relacionit.

F.Cekrezi: Realizimi i te ardhurave eshte poshte 60% , sa ka qene vitin e kaluar? Lidhur me investimet publike 2025/2026?

Dr.Finances: Vjet diku te 62/63% ishte realizimi i te ardhurave.Per 2025 rreth 60% investim te kryer nga buxheti i bashkise.

E.Carciu: Kam ngritur shqetesime lidhur me karburantin dhe punonjesit qe nuk shkojne 1 dite ne pune(supozon se karburanti i bashkise perdoret per perfitime personale te disa subjekteve, te cilat refuzon ti thote me emra konkrete, po ashtu edhe per punonjes qe nuk frekuentojne punen)

B.Ajazi: Ju lutem per cdo gje qe thoni me flisni me emera konkrete.

E.Guri: Shpenzime operative ka me shume sesa investime. Sa i perket realizimit te te ardhurave, NJA kane nga nje punonjes tatim/taksash, cila Nja ka realizimin me te madh?

B.Ajazi: E ka Nja Tunje.

E.Guri: Ne vijim te diskutimit nga keshilltari E.Carciu lexon targa makinash, qe sipas te cilit, marrin karburant ne emer te bashkise.

B.Ajazi: Karburanti eshte privat, une mbaj pergjegjesi kur hkon me karten e bashkise , me autorizim te bashkise, mi vertetoni sa jeni duke folur dhe te jeni te bindur per masat e ndeshkimit.

E.Zani: Votojme materialin?

***Miratohet pika 5 e rendit te ditës me 15 Vota PRO**

Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshe" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Xhulia Gjini

Luljeta Dollani

Ramazan Braho

Çështja 6

6- Mbi miratimin e subvencionimit të tarifës së pagesës për kullotat e livadhet për fermerët e që kanë kontratë qiraje në ekonominë pyjore /kullosore Vidhan-Skëndërbegas.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri, Alketa Bici.

Xh.Muca: Nga zjarret që rane u demtua një pjesë e madhe e kullotes. Në material bëhet fjalë për 50% subvencionim të 5 fermereve, ra aktualisht janë 5 kontrata të lidhura me bashkisë Gramsh dhe fermerët e zonës në ekonominë pyjore Vidhan/Skenderbegas, dhe për këta fermere kërkojmë dakortësinë për subvencionim në shumën 50% të tarifës së pagesës për fermerët.

B.Ajazi: Zona ka pësuar djegie të madhe, barinjte ankohen për pjesën e kullotes, vetë nga natyra nuk ka shumë kullote dhe një pjesë u dogj. Në i propozojmë këshillit që atë shumë që u rrit ta subvencionojmë në për të mbështetur (u rrit 1 mijë lekë për krerë)

K.Cala: Une propozoj që për gati 5 vite këtu të zerohen tarifatat për kullotat.

B.Ajazi: Nëse për këte vit është e zgjidhshme, i pergjigjmi kesaj kerkese, në jemi dakort (konsultohet me drejtorin e financave).

V.Bici: A keni kerkese të qytetarëve që nuk i keni dhënë pergjigje lidhur me kullotat?

B.Ajazi: Po kemi, do marrin kohën e vetë për tju pergjigjur.

D.Hazizaj: Bashkia vetëm atë zonë ka për kullotat?

Xh.Muca: Ka edhe të tjera por në po i referohemi kesaj zonë për shkak të kerkesave dhe për shkak të rënës së zjarreve.

E.Guri: A keni planifikuar për ndërtim lera uji për bagetinë? (tregon një problematike konkrete të një qytetari).

Xh.Muca: Në buxhetin e bashkisë nuk kemi miratuar ndërtim lera uji për 2026, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë jemi në bisedime për financimin e 8 lerave, për vitin 2027 do jete prioritet në buxhetin e bashkisë për ndërtim lera uji për bletorinë.

E.Zani: Hedhim në votim, sikurse u propozua, pra të kalohet pa taksa për këte vit?

***Miratohet pika 6 e rendit të ditës me 15 Vota PRO**

Nuk ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani

Adresa: Sheshi "Kamber Dermishi" Bulevardi "10 Korriku" Tel.Fax:0513 2 2272 E-mail:bashkiagramsh@gmail.com

Luljeta Dollani

Ramazan Braho

Çështja 7

7- Per miratimin e e Raportit të Komisionit të Shëndetsisë, Çështjeve Sociale dhe Konsumatorit.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri, Alketa Bici.

Lexohet raporti i Komisionit të Shëndetsisë, dhe të gjitha kërkesat e qytetarëve që paraqesin problematika shëndetsore. Janë kërkesa që sipas komisionit përmbushin kriteret ligjore dhe dokumentacioni është i plotë.

D.Finances : Janë gjendje 1,4 mln leke nga fondi.

B.Ajazi: Vendimmarrja i takon këshillit por unë donte propozoja të jepej nga 1 mln leke të vjetra secilit rast të paraqitur.



E.Zani: Votojme?

***Miratohet pika 7 e rendit të ditës me 15 Vota PRO**


Nuk Ka vota Kunder

Nuk ka Vota Abstenim

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani



Luljeta Dollani dhe *Ramazan Braho*

Çështja 8

8- Per miratimin e e Raportit të Komisionit të Dhënieve të Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit.

Në mbledhje marrin pjesë 15 këshilltarë: Enis Zani, Luljeta Dollani, Arnilda Dakare, Fatbardh Cekrezi, Brunilda Gjevori, Dalip Hazizaj, Ramazan Braho, Valbona Verushi, Visarion Bici, Erald Carciu, Erisa Zogu, Marsela Ibro, Kodhel Cala, Edmond Guri, Alketa Bici.

Kryetarja e Komisionit lexon te gjitha propozimet sipas Raportit qe i eshte paraqitur keshilltareve.

1- Nga propozimi i 3 pikave te para te cilat pas relatimit hidhen ne votim, **Keshilli voton unanimitisht me 15 vota pro :Kerkesen per emertim “Shtepi Baze e Luftes” per deshmorin Petref Nazif Zhupani.**

Kerkesat e tjera per emertime rruge, i le ne shqyrtim per me pas, pas marrjes se mendimit te komunitetit lidhur me keto propozime.

2-Per propozimin e vendosjes se Bustit Xhemal Mestan Ujaniku, kemi perfaqesues te autorizuar per mbrojtjen e propozimit, nga familja Musabelliu, per te folur ne emer te tyre.

Propozuesi: Familja Musabelliu ka qene e ludhur qe ne fillim me luften (tregon historine e kesj familje, referoju regjistrimit audio ne facebook te keshillit te kesaj mbledhje). Tregon lidhjen qe ka me Suloven.

E.Zani: Pse busti nuk kerkohet te vihet ne Skrapar?

V.Verushi: Duhet te flasin historianet per kete propozim.

E.Zani: Vendodhja diskutohet ne disa vende te ndryshme , edhe une jam i propozimit qe te flasin historianet.Sot ne mengjes ju me thate per tjetere vendodhje , ne Skenderbegas.



B.Ajazi: Sillni fakte historike, dokumente qe vertetojne figuren dhe kontributin e tij , Keshilli nuk eshte kunder por kerkohen prova historike te dokumentuara.

E.Zani : Pritet konfirmin dhe degjese nga komuniteti dhe sidomos fakte / dokumenta historike lidhur me figuren dhe kontributin e tij.



3-Pika e 3-te ne Raport flet per propozimet per disa qytetare, per tu dhene titulli Qytetar Nderi. Relatohen te gjitha propozimet , lexohet secili jeteshkrim i personave te propozuar. Komisioni ka zhvilluar punen e tij mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi, dhe ne VKB nr 38 date 29/05/2026 per miratimin e Udhezuesit per dhenien e Titujve Vendore te Nderit, dhe sipas Aneksit bashkengjitur ka bere vleresimin me sistem pikezimi.

Keshilli vlereson se nuk duhen kaluar per miratim propozimet e mesiperme , per mospermbushje te kriterëve dhe pikezimit maksimal te kerkuar, per te marre kete titull.

Sekretari Këshillit
Xhulia Gjini



Kryetari Këshillit
Enis Zani





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Gramsh, më 30 /06/2026

LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK
Mbledhja e Rradhës e Këshillit Bashkiak për Muajin QERSHOR 2026

EMER MBIEMER	30 QERSHOR 2026	EMER MBIEMER	FIRMA
1- ENIS ZANI	30.06.2026	Enis Zani	
2- VALBONA VERUSHI	30/06/2026	Valbona Verushi	
3- LULJETA DOLLANI	30/06/2026	Luljeta Dollani	
4- KODHEL CALA	30/06/2026	Kodhel Cala	
5- GRETA LENA			
6- VISARION BICI	30.06.2026	Visarion Bici	
7- ARDIANA HASA			
8- ALKETA BICI	30.06.2026	Alketa Bici	
9- RAMAZAN BRAHO	30.06.2026	Ramazan Braho	
10- EDMOND GURI	-II-	EDMOND GURI	
11- ERALED ÇARÇIU	30.06.2026	Erald Çarçiu	
12- IDRI KOKLA			
13- ERISA ZOGU	30.06.2026	Erisa Zogu	
14- KUJTIM BRAHIMI			
15- MARSELA IBRO	30.06.2026	Marsela Ibro	
16- ALFRIDA SHAHINI			
17- DALIP HAZIZAJ	30.06.2026	Dalip Hazizaj	
18- ARNILDA DAKARE	30.06.2026	Arnilda Dakare	
19- BRUNILDA BALLOLI			
20- FATBARDH ÇEKREZI	30.06.2026	Fatbardh Çekrezi	
21- BRUNILDA GJEVORI	30.06.2026	Brunilda Gjevori	

SEKRETARI I KËSHILLIT
XHULIA GJINI